

V E N D I M
Nr.291, datë 21.6.1994

PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË APARTAMENTEVE QË NDËRTOHEN ME FONDE SHTETËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Enti Kombëtar i Banesave, për vlerësimin e apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore, do të zbatojë këto kritere për shitjen e tyre:

1. Për qytetarët e pastrehë, vlefëta e apartamentit që Enti Kombëtar i Banesave do t'u shesë atyre, do të llogaritet sipas vlerës reale të ndërtimit vlerësuar në dollarë në momentin e shitjes.

Në momentin e lidhjes së kontratës këta qytetarë do të parapagujnë 10 për qind të vlefës së apartamentit, por jo më shumë se 50 për qind e të ardhurave familjare vjetore.

Shlyerja e vlefës së apartamentit do të bëhet për një periudhë maksimale prej 25 vjetësh, pa interes. Mënyra e pagesës do të jetë me këste mujore, të cilat do të llogariten në bazë të detyrimit vjetor, por jo më shumë se 20 për qind e të ardhurave familjare. Diferenca vjetore e papaguar e këstit kalon si detyrim në vitin pasardhës.

Për qytetarët e pastrehë që në bazë të ligjit "Për privatizimin e banesave shtetërore" i marrin banesat falas, llogaritja do të bëhet si më lart, por do të përballohet nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave.

2. Për qytetarët që kanë përfituar nga ligji nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", si ushtarakë, të transferuar, persona shtetërorë etj., vlefëta e apartamentit të ri do të llogaritet sipas koston reale të ndërtimit në momentin e shitjes e kovertuar me vlerën e dollarit në atë moment.

Në momentin e lidhjes së kontratës këta qytetarë do të parapagujnë 20 për qind të vlefës së apartamentit.

Shlyerja e vlefës së apartamentit do të bëhet për një periudhë maksimale prej 15 vjetësh, me interes 3,5 për qind. Mënyra e pagesës do të jetë me këste mujore, të cilat do të llogariten në bazë të detyrimit vjetor, por jo më shumë se 30 për qind e të ardhurave familjare. Diferenca vjetore e papaguar e këstit kalon si detyrim në vitin pasardhës.

3. Për qytetarët që kanë përfituar nga ligji nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe që i dorëzojnë apartament Entit Kombëtar të Banesave, vlefëta e apartamentit të ri do të llogaritet si në pikën 2, duke zbritur vlefën e apartamentit të dorëzuar, të rivlerësuar sipas çmimeve të Entit Kombëtar të Banesave.

Në momentin e lidhjes së kontratës këta qytetarë do të parapagujnë 10 për qind të vlefës së apartamentit, por jo më shumë se 50 për qind e të ardhurave vjetore familjare.

Shlyerja e vlefës së apartamentit do të bëhet për një periudhë maksimale prej 10 vjetësh, pa interes. Mënyra e pagesës do të jetë me këste mujore, të cilat do të llogariten në bazë të detyrimit vjetor, por jo më shumë se 20 për qind e të ardhurave familjare. Diferenca vjetore e papaguar e këstit kalon si detyrim në vitin pasardhës.

4. Për qytetarët që marrin apartament të ri mbi vlerën e caktuar në bazë të normave të strehimit në fuqi, llogaritja e vlefës së apartamentit do të bëhet përkatësisht sipas tri rasteve të mësipërme. Sipërfaqja mbi normat e strehimit do të vlerësohet dhe do të paguhet së bashku me paradhënien, në momentin e lidhjes së kontratës me Entin Kombëtar të Banesave.

5. Kur pagesa bëhet në mënyrë të menjëhershme, do të ketë një zbritje të vlefës totale të apartamentit prej 30 për qind për rastet e parashikuara në pikën 1, dhe 10 për qind zbritje për rastet e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

6. Për të gjitha rastet e parashikuara në pikat 1,2,3 dhe 4, duke përfshirë edhe rastet kur banesa kalon falas në pronësi të qytetarit, vlefëta e truallit do të llogaritet veçmas dhe i shtohet vlerës së apartamentit.

7. Për të gjitha rastet e parashikuara në këtë vendim, Enti Kombëtar i Banesave aplikon një

shumë prej 2 për qind të vlerës së apartamentit për shpenzime operacionale.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi